



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:155239

Datë: 24.02.2021

Numri i dokumentit: 01536822

P.nr.1014/20

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Shpresa Emra me pjesëmarrjen e sekretares juridike Birsën Shoshani, në çështjen penale kundër të akuzuarit K.M., nga Prizreni, për shkak se ka kryer veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par. 1 dhe 2 të KP, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II nr.1822-1/20 të datës 10.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, Prokurorit të Shtetit Mehreme Hoxha, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. B.K., me datë 10.02.2021, publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

K.M., nga i ati dhe e ëma, i lindur më në, me banim në Prizren në rr. nr., është me profesion bujk, ka të kryer fakultetin i martuar babë i një fëmije, identifikohet me letër njoftim nr., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. tel.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 22.08.2020, rreth orës 22.00, në Prizren, në rr. nr., saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët familjare, kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër, brenda një marrëdhënie familjare, ndaj të dëmtuarës-bashkëshortes së tij F.Q., pas një mosmarrëveshjeje lidhur me punët e shtëpisë, ku i pandehuri K.M., i kishte thënë bashkëshortes së tij që ajo ta pastronte dhomën e nënës së tij, pasi që nëna e të pandehurit ishte ankuar tek ai se gruaja e tij nuk e kishte pastruar dhomën e saj, e dëmtuara- bashkëshortja e tij pasi shkon dhe e pastron dhomën e vjehrrës së saj, i pandehuri e sulmon fizikisht duke e goditur në pjesën e gojës dhe i thotë “ mos të ndodh edhe njëherë që mos ta pastrosh dhomën e nënës sime”, me të cilat veprime të dëmtuara ka shkaktuar ndjenjën e frikës, shqetësimit dhe rrezikshmërisë personale.

Me këto veprime ka kryer veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par. 1 dhe 2 të KP.

Andaj gjykata me në harmoni me nenet 7,8,9,10,41,42,43,44,69,70 dhe të nenit 248 par. 1 të KP të akuzuarin e

G J Y K O N

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve të cilin dënim gjykata me propozim të mbrojtësit të akuzuarit dhe pëlqimin e të akuzuarit, në kuptim të nenit 44 të KP, dënimin e shqiptuar ia zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 800,00 (tetëqind)€ dhe DENIM ME GJOBË në lartësi prej 200(dyqind) Euro të cilin dënim i akuzuari është i obliguar të paguajë , në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk e paguan ose nuk ka mundësi të paguaj këtë gjobë të njëjtit dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur për çdo 20 € një ditë burgim, respektivisht nga shuma e dënimit me gjobë të zëvendësohet dënimi burgim prej 6(gjashtë) muajve.

E dëmtuara F.Q., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20€ si dhe në emër të fondit për kompensim të viktimave shumën prej 30€ ,të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate ka parashtruar Aktakuzë PP/IIInr.1822-1/20 të datës 10.11.2020 kundër të akuzuarit K.M., nga Prizreni, për shkak se ka kryer veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par. 1 dhe 2 të KP.

Gjykata në këtë çështje penale, respektivisht duke vepruar sipas Aktakuzës ka caktuar shqyrtimin fillestar, në të cilin shqyrtim i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilët akuzohet sipas aktakuzës.

Bazuar në aktin e pranimit të fajësisë dhe konform dispozitave të nenit 246 e 248 të KPP-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtimin ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datë 22.08.2020, rreth orës 22.00, në Prizren, në rr. nr....., saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët familjare, kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër, brenda një marrëdhënie familjare, ndaj të dëmtuarës-bashkëshortes së tij F.Q., pas një mosmarrëveshjeje lidhur me punët e shtëpisë, ku i pandehuri K.M., i kishte thënë bashkëshortes së tij që ajo ta pastronte dhomën e nënës së tij, pasi që nëna e të pandehurit ishte ankuar tek ai se gruaja e tij nuk e kishte pastruar dhomën e saj, e dëmtuara- bashkëshortja e tij pasi shkon dhe e pastron dhomën e vjehrrës së saj, i pandehuri e sulmon fizikisht duke e goditur në pjesën e gojës dhe i thotë “ mos të ndodh edhe njëherë që mos ta pastrosh dhomën e nënës sime”, me të cilat veprime te e dëmtuara ka shkaktuar ndjenjën e frikës, shqetësimit dhe rrezikshmërisë personale.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili vullnetarisht ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat.

Sipas detyrës zyrtare gjykata, konform nenit 257 të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimit i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzime. Pranimit i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me kohë me të gjitha provat materiale.

Gjykata erdhi në përfundim, se pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së dhe faktet që përmban aktakuza, ku në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të dhunës në familje nga neni 248 par. 1 të KP, ku për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe ia shqiptoi dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve të cilin dënim ia zëvendësoi me dënim me gjobë në shumë prej 800 € dhe dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind)€.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KP-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjatë vendosjes mbi dënimin, gjykata si rrethanë të veçantë rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit konsideron faktin se kemi të bëjmë me veprën penale të dhunës në familje, ndërsa si rrethana lehtësuese ka konsideruar: pranimin e fajësisë nga i akuzuari në shqyrtimin fillestar i cili në shqyrtim ka theksuar se është e vërtet që ka pasur mosmarrëveshje me bashkëshorten e tij dhe se ka shkaktuar dhunë ndaj saj, por ata i kanë rregulluar raportet dhe nuk kanë më probleme në mes tyre. I vjen keq që kjo ka ndodhur, ka qenë reagim momental, është penduar për veprimin e bërë dhe i premtonte gjykatës që nuk do të ndodh më.

Andaj duke u bazuar në këto rrethana, gjykata të akuzuarit i shqiptoi sanksionin penal sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se sanksioni shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale juridike të tij dhe se me këtë sanksion do të arrihet qëllimi preventiv i dënimit që në të ardhmen të jetë më të kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës në kontest të rregullt civil është marrë në kuptim të nenit 463 të KPP.

Vendimi mbi pagesën e kompensimit për Fondin e Kompensimit të viktimave është marrë në kuptim të nenit 6 dhe 39 par.3 pik.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensim të Viktimave të Krimit .

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në kuptim të nenit 450, 451 dhe 453 të KPP-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
P.nr.1014/20 e dt.10.02.2021

2020:155239, 24.02.2021

Gjyqtari

Shpresa Emra

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.